



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL LEZHË**

Nr. _____ Prot.

Data 28.03.2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mirembajtje e objekteve te Spitalit Rajonal Lezhe”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimore: 45

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,315,000.00 (dy milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

Argumentim:

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe V.K.M.-së, Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit te tregut, bazuar ne mesataren e cmimeve te marra nga ky studim;
ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në përfundim të punës grupi u referua ne nenin 76 te V.K.M. Nr 285, datë 19.05.2021, pika

a)çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj) si dhe **VKM.-në** Nr. 216, datë13.04.2023 ” Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të

integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe në analiza punimesh për ato zëra që nuk gjenden në këtë manual.

Afati i realizimit të punimeve është **40 (dyzete)** dite nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

3-LLOJI I PROCEDURËS SË PROKURIMIT: “E Hapur e thjeshtuar”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 8**:

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).
(nuk është i aplikueshëm)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kriteri 2.2.1. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës:.

Shuma e xhiros vjetore nuk duhet të jete me e vogel se : 465,000.00 (katerqind e gjashtedhjetë e pese mije) leke

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/c, 43 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Gjithashtu lidhur me përcaktimin e viteve të kërkuara për paraqitjen e dokumentacionit lidhur me xhiron vjetore, sqarojmë se afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave të kësaj procedure prokurimi përkon afërsisht me mesin e muajit Prill 2025, rrjedhimisht për këtë arsye operatorët ekonomik kanë kohë të mjaftueshme për paraqitjen e një kopje të deklaratës së xhiros vjetore të realizuar edhe për vitin 2024.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore **brenda dates 31 mars te vitit pasardhes,**

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

bërë bazuar ne ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

Kriteri 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

- a) ***punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;***
 - Shuma e kontratave të ngjashme nuk duhet të jetë më e vogël se: 930,000.00 (nëntëqind e tridhjetë mijë) leke.
- b) ***punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.***
 - Shuma e kontratave të ngjashme nuk duhet të jetë më e vogël se: ,315,000.00 (dy milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë) leke.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat,

autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet 38 tatimore³⁶ dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punë të ngjashme të jenë në vlerën **jo më të madhe se 50%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për punë, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 50% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Eshtë kërkuar që pune të ngjashme të jenë në vlerën 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 50% të vlerës së përlogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontraten/at e Sipërmarrjes,
 - Situacioni përfundimtar i objektit, dhe faturat tatimore përkatëse
 - Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojces nr.9,
 - Akt Kolaudimi/Çertifikaten e marrjes në dorezim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontraten/at e Sipërmarrjes,
 - Situacion përfundimtar të objektit, dhe faturat tatimore përkatëse
 - Formular Vlerësimi ose vërtetim realizimi nga Investitori
 - Akti i Kolaudimit/Çertifikaten e marrjes në dorezim.

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Kriteri 2.3.2. Operatoret ekonomike duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me V.K.M.-në, Nr.42, datë 16.01.2008) e ndryshuar. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”*, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në V.K.M. Nr. 42, date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme (N.P-3 A, etj) i përmbahet parashikimeve ligjore dhe kërkesave për rikonstruksion të objektit.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

NP - 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash. Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv që kanë të bëjnë me punimet e brendshme të rikonstruksionit (patinim, lysterje, etj), etj.

Sipas parashikimit të V.K.M., Nr. 42 date 16.01.2008, përcaktimi i nivelit “A” të kategorive të licencave në këto procedure prokurimi është bërë në bazë të Lidhjes 4, të V.K.M. në fjalë, sipas të cilës, për punime ndërtimore në vlerën deri në 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”.

Kriteri 2.3.3. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar, si me poshte:

Stafi	Nr.
Drejtues teknik - Inxhinier ndërtimi	1 (nje)
Puntor bojxhi	2 (dy)
Punetor ndertimi	2 (dy)
Total	5 (pese)

a) Për drejtuesin teknik të paraqitet:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Inxhinier Ndertimi.

- Kontrate pune perkatese.
- Libreze pune.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.
- Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet te figuroje i dy punesuar ne sektor privat apo publik. Per kete Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise te paraqes deklarate perkatese.
- Drejtuesi nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes
----	--------------	------------	---

Shënim 2.1 : Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe diplomat/certifikatat e cdo punonjesi prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

Shënim 2.2:Me qellim garantimin e gjithe perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shenim: Ky kriter ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik do te konsiderohet i permbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 9 te DST. Ne rastet kur OE do te shpallet fitues duhet te paraqese dokumentacionin provues sipas ketij kriteri.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me germen b dhe c pika 4 te nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Ky kriter mbeshetet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”.

Ky kriter eshte plotesuar ne baze te volumit te sherbimeve sipas zerave te sherbimeve, te percaktuara ne preventivin e sherbimeve, specialistët e mësipërm, janë përcaktuar në përputhje me listen e sherbimeve. Pra janë vendosur kërkesa të cilat lidhen ngushtë aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Dëshmia profesionale dhe dëshmia kualifikimit teknik, janë kërkuar nga AK për t'u siguruar në aftësitë e specialistëve për zbatimin korrekt të sherbimeve si dhe që këta specialistë kanë njohuritë e duhura për rregullat e sigurimit teknik në punë.

Kriteri 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin e kontratës si më poshtë.

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
-----	--------------------	---------	-------

	Kamioncine	Në pronësi ose me qira	Copë 1
	Skele	Ne pronesi ose me qira	1200 m2
	Paisje P.P.E.	Në pronësi ose me qira	4 Sete

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa, operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesinë e mjetit: leja e qarkullimit; çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; pagesën e taksave vjetore
Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase, e cila duhet të përshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet/pajisje të deklaruar.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të D.S.T. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë

autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me L.P.P. dhe V.K.M. nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Shenim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për keto pika do të jetë kusht skualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes, bashkëngjitur D.S.T. në S.P.E.

Boje hidroplastike.

Me boje Hidroplastike do te behet lysterja e Poliklinikes nga jashte me nje siperfaqe prej **1200 m2**

Gjithashtu do te behet lysterja nga jashte e te gjithë objekteve brenda territorit te Spitalit Lezhe me nje siperfaqe **prej 2200 m2** ku perfshihet farmacia , morgu ,ambjentet teknike dhe zyrtat gjithashtu dhe pjesa e grafise dhe punktut te gjakut.

Ne katin e pare ne Pavionin e Patologjise

Sip.Kati 1 Materniteti I ri

Depo	51.9	m2
Dhoma 101	51.9	m2
Dhoma 102	52.5	m2
Dhoma 103	58.8	m2
Dhoma 104	56.7	m2
Dhoma 105	56.7	m2
Dhoma 106	56.7	m2
Dhoma 107	56.7	m2
Dhoma 108	56.7	m2
Dhoma 109	57	m2
Infermieri	48.2	m2
Kinfermieri	51.6	m2
Salla mikrokirurgjise	70.8	
Total	726	

Siperfaqja totale e lysterjes se ketyre ambjenteve do te jete 726 m2

Ne katin e dyte ne Pavionin e Obstetrikes

Sip.Kati 2 Materniteti I ri

Depo	31.5	m2
Dhoma 201	51.9	m2
Dhoma 202	67.5	m2

Dhoma 203	58.8	m2
Dhoma 204	56.7	m2
Dhoma 205	56.7	m2
Dhoma 206	56.7	m2
Dhoma 207	56.7	m2
Dhoma 208	56.7	m2
Dhoma 109	57	m2
Infermieri	48.2	m2
Kinfermieri	51.6	m2
Zyre	27.6	m2
Kontroll	27.6	m2
Neonat	55.8	m2
Neonat	82.2	m2
Mjek neonat	59.1	m2
Total	902	

Siperfaqe kati I trete materniteti

Sip.Kati 3 Materniteti I ri

Zyre	55.5	m2
Salla mbledhje	58.5	m2
Rizgjimi	60.3	m2
Infermieri	64.5	m2
Reanimacion	51	m2
Total	290	

182 m2 do te behet lysterja e recepsionit dhe korridorit hyres ne katin perdhe.

Boje vaji siperfaqe druri.

Derrasat te cilat do te vendosen per stolat e Spitalit do te lyhen te gjitha me boje vaji .

Boje vaji siperfaqe metalik.

Me boje vaji do te lyhet pjesa metalike e stolave ekzistues te Spitalit Rajonal Lezhe . Do te behet mire pastrimi I hekurave nga ndryshkjet e mundshme dhe perpara se te lyhen do te lyhen me antokorrozion.
Skele tubo fasade > 12m.

Skela do te vendoset ne objektin e Poliklinikes i cili eshte nje objekt 4 kate .

Shtrese derrasa FM 4.0cm.

Me derrasa do te behet nderrimi I te gjitha derrave te stolave ekzistues qe ndodhen ne territorin e spitalit.Derrasa do te jete 4 cm e lemuar dhe e lyer me boje vaji .

FV tabela te ndryshme rrugore D=90cm.

Tabelat do te jene drejtkendore dhe rrethore.

FV tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti.

Tabela do te inkastrohet ne toke me bazament betoni dhe njera do te vendoset ne hyrje te Spitalit ne menyre qe te behet orientimi i duhur i pacienteve ne territorin e Spitalit ndersa tjetra do te vendoset ne hyrjen tjetere te spitalit ku edhe ketu do te vendoset orientimet e pacienteve neper pavionet e Spitalit.Permasat do te jene 90x120 cm

Patinim muri allçi (stuko).

Ky ze parashikon patinimin e te gjitha zonave te demtuara te suvatimit ne menyre qe te behet lyerja cilesore e tij

F.V Mbrojtese druri ne lartesine 1.1 per korridoret.

Gjeresia e mbrojtases do te jete 20 cm dhe me trashesi 4 cm e cila duhet te jete e lyer mire si dhe me nje boje antibakteriale dhe e pagervishtshme.


F.V Kosha mbeturinash.

Kosh mbeturinash për ambient të jashtëm, metalik, i bardhë/jeshile, 50x48xH115 cm.

Do te behet nje bazament betoni ne menyre qe koshi te jete statik.

Specifikime teknike

- Gjerësia: 50 cm
- Lartësia: 115 cm
- Materiali: Metalik
- Ngjyra: E bardhë/jeshile
- Thellësia: 48 cm



Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 30 dite nga lidhja e kontrates

1	2	3.Afati i Realizimit				
NR	EMËRTIMI I PUNIMEVE	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 1	Java 3/Muaji 1	Java 4/Muaji 1	Java 5/Muaji 1
	1. PUNIME BOJATISJE					
1	Boje hidroplastike					
2	Boje vaji sipërfaqe druri					
3	Boje vaji sipërfaqe metalik					
4	Skele tubo fasade > 12m					
5	Shtrese derrasa FM 4.0cm					
6	FV tabela te ndryshme rrugore D=90cm					
7	FV tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti					
8	Patinim muri allçi (stuko)					
9	F.V Mbrojtëse druri ne lartësi 1.1 per korridoret					
10	F.V Kosha mbeturinash					

Sasia dhe Grafiku I levrimit : janë vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 39 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar

se: Autoriteti/enti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve.

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 42 pika 2 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 i ndryshuar përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :
14.04.2025 ora 09:00.**

NJËSIA E PROKURIMIT

- **Alfred Gjoni** - Inxhinier Ndertimi/Sektori Teknike
- **Rajmonda Huba** - Specialiste/Sektori i Planifikim Prokurimeve
- **Ornela Zeneli** - Specialiste/Sektori i Planifikim Prokurimeve